



Republika e Kosovës
Republika Kosova - Republic of Kosovo
Qeveria - Vlada - Government

Nr. 07/106
Datë: 11.06.2019

Në mbështetje të nenit 92 paragrafi 4. dhe të nenit 93 paragrafi (4) të Kushtetutës së Republikës së Kosovës, të nenit 95, paragrafi 2, i Ligjit Nr. 04/L-042 për Prokurimin Publik të Republikës së Kosovës, i Plotësuar dhe Ndryshuar me Ligjin Nr. 05/L-068 dhe me Ligjin Nr. 05/L-092, të nenit 3, paragrafi 1, i Udhëzimit Administrativ QRK - Nr. 06/2018 për Zbatimin e Procedurave Qendrore të Prokurimit Publik, duke u bazuar në nenin 4 të Rregullores Nr. 02/2011 për Fushat e Përgjegjësisë Administrative të Zyrës së Kryeministrit dhe Ministrive, e ndryshuar dhe e plotësuar me Rregulloren Nr. 15/2017, me Rregulloren Nr. 16/2017, me Rregulloren Nr. 07/2018, me Rregulloren Nr. 26/2018 dhe me Rregulloren Nr. 30/2018, në pajtim me nenin 19 të Rregullores së Punës së Qeverisë së Republikës së Kosovës Nr. 09/2011, Qeveria e Republikës së Kosovës, në mbledhjen e mbajtur më 11 qershor 2019, nxjerr këtë:

V E N D I M

1. Aprovohet ndryshimi i listës së artikujve për përdorim të përbashkët që janë objekt i procedurës qendrore të prokurimit publik, e bashkëngjitur në Shtojcën e këtij vendimi.
2. Obligohet Agjencia Qendrore e Prokurimit dhe Komisioni Rregullativ i Prokurimit Publik të bëjnë shpalljen e këtij vendimi sipas nenit 95, paragrafi 2, i Ligjit për Prokurimin Publik në Republikën e Kosovës.
3. Obligohet Agjencia Qendrore e Prokurimit për zbatimin e këtij vendimi.
4. Vendimi hyn në fuqi ditën e nënshkrimit.

Ramush HARADINAJ

Kryeministër i Republikës së Kosovës

Iu dërgohet:

- Zëvendëskryeministrave
- të gjitha ministrive (ministrave)
- Sekretarit të Përgjithshëm të ZKM-ës
- Arkivit të Qeverisë

Shtojcë - Artikujt dhe shërbimet që janë pjesë e prokurimeve të përbashkëta

Nr.	Përshkrimi	Lloji i kontratës	Kohëzgjatja në vite
1	Furnizimi me letër për kopje	Kornizë	3
2	Furnizimi me material zyrtar	Kornizë	3
3	Furnizimi me goma për automjete	Kornizë	3
4	Furnizimi me vetura të udhëtarëve	Kornizë	3
5	Furnizim me artikuj ushqimor	Kornizë	3
6	Furnizim me mobile	Kornizë	3
7	Furnizim me TI	Marrëveshje	3
8	Furnizim me pemë dhe perime	Marrëveshje	3
9	Marrja me qira e veturave të udhëtarëve	Kontrate afatgjate	6
10	Shërbime fotokopjimi, skanimi dhe printimi- me qira	Kontratë afatgjate	6
11	Furnizim me karburante	Kornizë	3
12	Furnizim me Mazut	Kornizë	3
13	Shërbime transportit ajror	Kornizë	3
14	Furnizimi me ujë të pijes	Kornizë	3